

DOKUMENT I POLITIKAVE

PËRPARIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT PËRMES BUXHETIMIT TË PËRGJEGJSHEM GJINOR

Zvogëlimi i taksave për produktet esenciale të higjienës menstruale

Përgaditur nga EcoKosWomen (EKW)

HYRJE

Menaxhimi i Higjienës Menstruale është një çështje e të drejtave të njeriut sepse higjiena menstruale dhe qasja e përballueshme për produktet e higjienës menstruale është *esenciale* dhe e lidhur pazgjidhshmërisht me të drejtat për shëndetin, higjienën, arsimin, dinjitetin dhe punën, ndër të drejtat e tjera.¹ Vështirësitë të cilat i hasin vajzat dhe gratë në Menaxhimin e Higjienës Menstruale mund të ndikojnë negativisht në shkallën në të cilën ato gëzojnë të drejta të caktuara, përfshirë ato për arsim, punë dhe shëndet.² Praktikrat më të mira të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor vënë në pah përgjegjësinë që shteti ka të shqyrtojë se si merren të ardhurat dhe si bëhen shpenzimet, drejt sigurimit që politikrat e mbledhjes së të ardhurave të mos diskriminojnë gratë ose burrat. Nëse zbatohet siç duhet, BPGJ-ja mund të çojë në përdorim më të barabartë, më transparent, më efektiv dhe më efikas të fondeve publike.³ Ky dokument i politikave paraqet prova se përse Qeveria e Kosovës, sipas angazhimeve për buxhetimin gjinor, të drejtat e njeriut dhe barazinë, duhet të ulë ose heqë tërësisht taksën për produktet thelbësore, duke rritur kështu mirëqenien e grave dhe vajzave.

TË GJETURAT

Menaxhimi i Higjienës Menstruale - Një çështje e lënë pas dore

Të gjeturat e hulumtimit kryer nga EkoKosWomen në 2021, "Jetë e pastër për gra dhe vajza - Menaxhimi i higjienës menstruale", në bazë të anketës së cilës i janë përgjigjur 240 respondente, janë si vijon:

- Në një familje kosovare mesatarisht janë nga 2.4 vajza dhe gra me cikël menstrual;
- Mesatarisht një vajzë/grua shpenzon 55.77 € për produkte menstruale, ndërsa, brenda periudhës kohore sa janë me cikël menstrual (mesatarisht 37 vite) 2,063.49 €;
- 96.3% e vajzave / grave hasin në vështirësi të MHM, në shkollë ose vendin e punës;

¹ İlayda Eskitaşçioğlu, Qasja në produkte menstruale është e drejtë kushtetuese. Pikë. Mbi varfërinë menstruale dhe (jo)kushtetutëzimin e taksës së tamponit [Access to Menstrual Products is a Constitutional Right. Period. On Period Poverty and the (Un)Constitutionality of Tampon Tax], tek: <https://verfassungsblog.de/access-to-menstrual-products-is-a-constitutional-right-period/>.

² Human Rights Watch, WASH United, Të kuptuarit e menaxhimit të higjienës menstruale dhe të drejtat e njeriut [Understanding Menstrual Hygiene Management And Human Rights], gusht, 2017, tek: https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/mhm_practitioner_guide_web.pdf.


³ Nicole Farnsworth, Donjeta Morina, David JJ Ryan, Gresa Rrahmani, Vanessa Robinson-Conlon dhe Iliriana Banjska, Analiza Gjinore e Kosovës, Rrjeti i Grave të Kosovës 2018, tek: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2018/10/20181003170921410.pdf>.

- Në bazë të të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës në vitin 2019, paga mesatare në Kosovë është 430.00 €, ndërsa paga mesatare e të punësuarve në sektorin privat është 372.00 €. Tabela 1 ilustron se shpenzimet mesatare të produkteve higjienike menstruale për një familje janë:

	Paga mesatare neto, në Kosovë	Paga mesatare neto, në sektorin privat	Paga minimale në Kosovë, mbi moshën 35 vjeçare	Paga minimale në Kosovë, deri në moshën 35 vjeçare
Paga mesatare për një person, në muaj	€ 430.00	€ 372.00	€ 170.00	€ 130.00
Total çmimi për një muaj në një familje	€ 10.30	€ 10.30	€ 10.30	€ 10.30
Shpenzimet për një shportë të higjienës menstruale në një familje, brenda muajit	2%	3%	6%	8%

Produktet higjienike menstruale taten si mallra joesenciale

Ndërkohë që norma e reduktuar në 8% e TVSH-së vlen për mallra elementare ku hyjnë kontraktivët dhe produktet farmaceutike⁴ mes tjerash, pecetat higjienike absorbuese dhe tamponët nuk bëjnë pjesë në këto mallra pavarësisht nevojës esenciale për përdorimin e tyre nga pjesa dërrmuese e vajzave dhe grave në Kosovë. Në grafikun 1 mund të shihen të dhënat komerciale në Euro sipas kodit tarifor (HS-10) për importin e rregullt të produkteve menstruale, nga viti 2015 deri në vitin 2020. Pavarësisht nga nevoja për përdorimin e tyre nga gratë dhe vajzat⁵.



Grafiku 1

Sipas të dhënave zyrtare të Doganës së Kosovës, tek "RAPORTI VJETOR 2019" proporcioni i të hyrave nga TVSH (0.0532%) dhe taksës Doganore (0.0115%) për produktet higjienike menstruale nga totali i të hyrave vjetore të Doganës, është fare i vogël (0.065%).⁶

⁴ Udhëzimi Administrativ MF-Nr.03/2015 Për Zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-037 Për Tatimin Mbi Vlerën e Shtuar, fq. 278, tek: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11079>.

⁵ Dogana e Kosovës, Kodi Nr.03/L-109 Doganor dhe i Akcizave në Kosovë, 2014, tek: https://dogana.rks-gov.net/wp-content/uploads/2016/12/Kodi_Nr.03-L-109_Doganor_dhe_i_Akcizave_te_Kosoves_2525961.pdf.

⁶ Dogana e Kosovës, Raporti Vjetor 2019, Janar 2019, tek: https://dogana.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/12/Raporti_vjetor_per_vitin-2019.pdf.

Nëse bazohemi në të dhënat e mësipërme, heqja e taksës së Doganës dhe TVSH-së për pecetat higjienike dhe tamponët, nuk ndikon shumë në buxhetin total të të hyrave të Kosovës, por i ndihmon shumë gratë dhe vajzat, sidomos ato në familje të varfëra.

REKOMANDIME PËR MINISTRINË E FINANCAVE

- ✓ Produktet higjienike menstruale të klasifikohen si produkte esenciale, sepse hyjnë në kuadrin e të drejtave të njeriut dhe janë më se të nevojshme për jetën e përditshme të vajzave dhe grave.
- ✓ Si pjesë e obligimeve të Qeverisë për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, të ndërrohet Ligji Nr. 05/L-037 për tatimin mbi vlerën e shtuar, në mënyre që të bëhet heqja e taksave, ajo e Doganës dhe TVSH-së, nga produktet higjienike menstruale. Sipas Analizës Gjinore kjo taksë e hequr drejtpërdrejtë ndikon në buxhetin e përgjithshëm familjar dhe në të njëjtën kohë krijon qasje më të lehtë për blerjen e këtyre produkteve, posaçërisht tek familjet që kanë të ardhura të ulëta.